



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health

30 Prill 2020

Nr. Xx/2020

Bazuar në nenin 132 të Ligjit Nr. 05/L -031 - Për procedurën e përgjithshme administrative, nenin 38 të Ligjit 04/L-190- Për Produkte dhe Pajisje medicinale, nenin 17 të Udhëzimit Administrativ 02/2019 - Për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale, Vendimin nr. protokolli 35/2019, datë 27.06.2019, me rastin e shqyrtimit të kërkesës me Nr. 24, të datës 27.03.2020, nga Kompania **Green Pharm**, me seli në Prizren, me adresë: William Walker, me person përgjegjës **Moamer Tershnjaku**, të ushtruar kundrejt vendimit të komisionit për çmime të publikuar më 23 Mars në webfaqen e MSH, Komisioni për çmime, në takimin e mbajtur me datë 30.04.2020, nxjerr këtë:

VENDIM

Aprovohet pjesërisht kërkesa për rishqyrtim të çmimeve e parashtruar nga Kompania **Green Pharm**, me seli në Prizren rruga William Walker.

Çmimet finale janë si vijon:

1. Bodinet, Budesonide, Nebuliser Suspension 0.25mg/ml, 20 PCS 2ml: €5.44
2. Cicloviral, Aciclovir, Tablet 200mg, 25 PCS: €4.40

Arsyetimi

Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht komisioni për çmime bazuar në dispozitat e Udhëzimit Administrativ 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve medicinale pas zhvillimit të procedurave të parapara me aplikacionet, dhe evalumin e tyre më datë 23 Mars 2020 ka publikuar vendimin për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale të cilat posedojnë autorizim për marketing pranë AKPPM. Bazur në paragrafin 1 të nenit 17 kundër vendimit të komisionit pala ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim në komisionin për çmime në afat prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimeve.

Kompania **Green Pharm**, me seli në Prizren, rruga William Walker, bazuar në paragrafin 1 të nenit 17 të UA 02/2019, brenda afatit ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim të çmimeve të produkteve medicinale si vijon

1. Bodinet, Budesonide, Nebuliser Suspension 0.25mg/ml, 20 PCS 2ml për të cilin ka aplikuar për çmimin €10.00
2. Cicloviral, Aciclovir, Tablet 200mg, 25 PCS për të cilin ka aplikuar për çmimin €4.40

Komisioni duke u bazuar në dispozitat e udhëzimit administrativ përkatësisht në paragrafin 2 të nenit 17 të UA 02/2019 ka përcaktuar si vijon:


| Emri i produktit | INN | Forma farmaceutike | Fortesia | Madhesia e paketimit | Çmimi i deklaruar | Çmimi në € në vendet referente/originës | Çmimi final në Euro | Komenti nga komisioni |
|------------------|------------|----------------------|------------|----------------------|-------------------|---|---------------------|--|
| Bodinet | Budesonide | Nebuliser Suspension | 0.25mg /ml | 20 PCS 2ml | 10.00 | | 5.44 | Çmimi final është përzgjedhur në bazë të krahasimit me origjinator Pulmicort. |
| Cicloviral | Aciclovir | Tablet | 200mg | 25 PCS | 4.40 | | 4.40 | Në mungesë të çmimeve në shtetet primare dhe sekondare çmimi është vendosur sipas çmimit në vendin e origjinës / çmimit të deklaruar nga bartësi i MAH |

Nga sa u tha u vendos si në dispozit të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala ka të drejtë ankese 15 ditë kalendarike pas shpalljes së kësaj përgjigjeje në Bordin për Ankese për çmime të produkteve medicinale në Ministrinë e Shëndetësisë.

Komisioni për çmime:

1. Naim Bardiqi MSH kryetar
2. Selvete Shuleta AKPPM anëtare
3. Etrit Tetova AKK anëtar
4. Amir Keka FSSH anëtar
5. Shkumbin Jusufi OFK anëtar
6. Dardan Nallbani MTI anëtar
7. Blerta Kika MF anëtare



Handwritten signatures of the seven members of the Commission for Prices, each on a horizontal line.

Vendimi i dërgohet:

Palës,

Departamenti farmaceutik,

Arkivës.